



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA E QYTETIT KORCE  
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE

ADRESA : URA E FAJANCES

TEL

++355 824 3150

**KESHILLI I BASHKISE I QYTETIT KORCE**

**VENDIM**

Nr. 43 Date 23-6-2008

Keshilli i Bashkise i Qytetit te Korces,ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi mori ne analize relacionin e paraqitur nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike,"Per kalim ne privatizim",mbeshtetur ne Ligjin Nr. 8122 date 09.07.1996 "Per miratimin pa ndryshime te dekretit te Presidentit Nr. 1440 date 04.04.1996 "Per trajtimin e banesave shteterore te paprivatizuara".Banesat shteterore qe nuk jane privatizuar deri me daten 31.12.1995 dhe qe nuk jane objekt i Ligjit 7658 date 15.04.1993 "Per kthimin dhe kompesimin e prones", kalojne ne administrimin e organeve te pushtetit lokal ne Komuna dhe Bashki , sipas vendodhjes se baneses si dhe neni 2 i cili parashikon se " Keshillat e Bashkive ose Komunave ne varesi nga vendodhja , do te vendosin per privatizimin e tyre sipas kriterëve te Ligjit Nr. 7652 date 23.12.1992 "Per privatizimin e banesave shteterore", ku sipas te cilit eshte Keshilli i Bashkise qe vendos per miratimin e kalimit ne privatizim si dhe duke u mbeshtetur dhe ne vendimin e Bashkise Korce Nr. 97 date 11.09.2000 pika 1, mbeshtetur ne kopetencat qe ka si dhe pas diskutimeve te anetareve:

**VENDOSI**

1. Te kaloje ne privatizim banesa e ndodhur ne rrugen "Naum Karanxha" ,P.6 kati i dyte ,e perbere prej 1 dhome dhe kuzhine me sip 46.85 m2.Ne te cilin banon familja Adrian,Arben,Nevruz ,Besnik dhe Majlinda Rakipi.

~~2. Te behet kalimi i kontrates se qirase nga Agim Cenolli ne Pellumbe Zyberi dhe te kaloje ne privatizim banesa e ndodhur ne rrugen "Xh.C.Lubonja" P.1A/6 kati i trete i perbere nga 1 dhome e kuzhine me sip.46.85 m2,ne te cilin banon familja Pellumbe Zyberi.~~

3. Te kaloje ne privatizim banesa e ndodhur ne rrugen "Xhafer.C.Lubonja" P/24 kati i peste te perbere prej 1 dhome me sip 14.9 m2 dhe siperfaqe te perbashket prej 4.18 m2,ne te cilen banon familja **Thomaidha Vanko**.

4. Te kaloje ne privatizim banesa e ndodhur ne rrugen "Blloku i Ri i sportit",P/ 8,A/12,kati 4 e perbere prej 2 dhoma kuzhine me siperfaqe 79.46 m2 ,ne te cilen banon familja **Theofan Prifti**.

5. Te behet kalimi i kontrates se qirase nga Eleni Strati, (sot e vdekur) banuese ne rrugen "Theodhoraq Saro"Nr.7. ne emrin **Vasilika Topalli** pasi edhe te gjitha kontratat e tjera si Energjia Elektrike dhe Uji jane kaluar ne kete emer.

6. Te kaloje ne privatizim banesa e ndodhur ne rrugen "Spiro Ballkameni",P/1 B/14 kati i peste te perbere prej 1 dhome me siperfaqe 14.58 m2 dhe siperfaqe te perbashket 7.33 m2,ne te cilen banon familja **Vasil Miha**.

*Rajmonda Nese*  
**KRYETARI**  
**RAJMONDA NASE**

Dixhitalizuar nga Qendra CIP  
www.inocip.org